



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 22 Prot.

Tiranë, më 06 . 01 .2025

**V E N D I M**

**Nr. 7 , datë 06. 01. 2025**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën me nr. 169 Regj., datë 23.08.2024, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të shtetasit S. F, nga linja e transportit të udhëtarëve Bilisht-Korçë dhe anasjelltas.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, përfaqësuesi i kësaj Shoqate, z.S. F, parashtron se:  
*“Me datë 15.08.2024 po kthehesha nga Bilishti për në Korçë. Mora autobusin e Bilishtit rreth orës 8:30, me targë AA 102 PX.*

*Pas nisjes erdhi faturinoja i autobusit për të marrë lekët. Unë i nxora librezën dhe i thashë që personat e verbër duhet të udhëtojnë me 50% të çmimit të biletës por ai u përgjigj se është privat dhe nuk i njeh librezat. I kërkova biletë dhe nuk më dha, më tha ik ankohu ku të duash.*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*Pas këtij debati u detyrova të paguaj biletën e plotë. Në këtë linjë personave të verbër askush nuk ua njeh librezën.”*

Ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga linja e transportit Bilisht-Korçë dhe anasjelltas. Rregullimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës për përfitimin e lehtësive në transportin urban të PAK nga kjo linjë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Bazuar në nenin 32, pika 1/a), të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

➤ **Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:**

1. Në kushtet që, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Bilisht-Korçë dhe anasjelltas, me të cilën kishte udhëtuar në datën 15.08.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet shkresës me nr. 1180/1 prot., datë 29.08.2024, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Me shkresën nr. 16612/1 prot datë 02.09.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se:

“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhrit Nr. 318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave për operimin në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus.

Linja e rregullt e transportit të udhëtarëve Bilisht-Korçë-Bilisht është miratuar me Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe lëshimi i licencës/certifikatave për operimin në këtë linjë kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Bilisht-Korçë-Bilisht, është licencuar shoqëria “Xhea Trans” sh.p.k, me NIPT L36331601E, mbajtësi i licencës me nr. 97, lëshuar në datën 21.06.2022. me afat vlefshmërie deri në datën 20.06.2027.

Nga verifikimi i mjeteve të kërkuara nga ana juaj në sistemet e-DPSHTRR dhe e-Transport, rezulton se:

- Mjeti me targë AA 102 PX është në pronësi të subjektit juridik “Xhea Trans” shpk dhe rezulton i pajisur me certifikatën me nr. 12, datë 19.06.2024, me afat vlefshmërie deri në datë 19.06.2025, për operimin në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Bilisht-Korçë-Bilisht”.

Pas marrjes dijeni nga ana e DPSHTRR, lidhur me subjektin privat, shoqërinë “Xhea Trans” shpk, i cili kishte në pronësi mjetin me targën respektive;

3. Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1180/3 prot., datë 12.09.2024 njoftoi subjektin, Shoqërinë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues dhe kërkoi informacionin e mëposhtëm:
  - Informacion nga ana e Shoqërisë “Xhea Trans” shpk, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesi.
  - Informacion lidhur me dokumentin që ka paraqitur subjekti ankues - cilën nga librezat e verbërisë ka paraqitur para faturinos: Librezën e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo Librezën e Verbërisë të lëshuar nga Shoqata Kombëtare Shpresë për të Verbërit?
  - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Xhea Trans” shpk, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”*.
  - Çfarë masash ka marrë Shoqëria juaj, lidhur me zbatimin e pikave të Licencës nr. 97 *“Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”*, sipas legjislacionit në fuqi për personat me aftësi të kufizuara, personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre?
  - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
  - A është paraqitur ndonjë ankesë pranë jush, lidhur me sa më sipër? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj. Parashtrime dhe kopje të akteve provuese, nëse ka.

4. Nëpërmjet shkresës me datë 07.10.2024, Shoqëria ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj përsa i takon pretendimeve të paraqitura nga subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se:

*“...në datën në fjalë në linjën Bilisht-Korçë, në drejtim të automjetit ishte një shofer i ri i punësuar nga Shoqëria jonë, i cili nuk ishte në dijeni mbi të drejtën e PAK për përfitimin e udhëtimit ndërqytetas me biletë me gjysëm çmimi.*

*Unë jam pronari legjitim i mjetit të mësipërm dhe mbas informimit të situatës nga ana e shoferit të Shoqërisë, kam telefonuar zotërinë duke i shpjeguar se kjo përgjegjësi është imja dhe sipas detyrimit ligjor do t'i ktheja diferencën e lekëve, por z. F nuk pranoi të merrte lekët dhe të sqaronim situatën në fjalë, por ju drejtua institucionit tuaj.*

*Përsa i përket librezës, shoferi as kishte dijeni se çfarë libeze ishte ajo dhe ne nuk kemi një përgjigje për këtë se cila nga të dyja librezat do të ishte e vlefshme për rimbursimin e detyrimit.*

*Megjithatë, Shoqëria “Xhea Trans” sigurisht që në zbatim të udhëzimeve bashkëlidhur Licencës nr. 97, ofron shërbim për personat me aftësi të kufizuara.*

*Masat e marra pas këtij episodi, janë informimi i personelit të Shoqërisë për detyrimin ligjor për marrjen e biletës së udhëtimit në vlerën 50% të biletës për PAK.*

*Pranë Shoqërisë tonë nuk është paraqitur asnjë ankesë dhe ky ishte rasti i parë, që megjithë vullnetin tonë për ta zgjidhur me mirëkuptim, nuk u realizua pasi u refuzua nga ana e ankuesit”.*

Në vijim, nga ana e KMD-së ankuesit i është bërë e njohur përmbajtja e parashtrimeve të dërguara nga ana e Shoqërisë “Xhea trans” shpk.

5. Komisioneri nëpërmjet e-mailit të datës 05.11.2024, ka vënë në dispozicion të palës ankuese, kopje të dokumentacionit të dërguar nga Shoqëria “Xhea Trans” shpk, e cila megjithë marrjen dijeni të sa mësipër, nga ana e palës ankuese nuk është depozituar asnjë parashtrim apo qëndrim për sa është informuar nga Shoqëria, lidhur me kërkimin e ndjesës dhe masat e marra.
6. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1180/5 prot., datë 11.11.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore,.

Secilës nga palët i është bërë i ditur fakti që, mund të depozitojnë gjatë seancës, shpjegime si dhe dokumentacion provues në favor të argumentave të veta.

7. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 21.11.2024, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e palës ankuese personalisht, në mungesë të përfaqësuesve të Shoqërisë, të cilët kishin njoftuar paraprakisht nëpërmjet e-mailit datë 20.11.2024, se:

*“...për arsye objektive e kemi të pamundur të paraqitemi fizikisht, ndërohe që, ju sqarojmë se subjekti ynë ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke informuar operatorët e linjës Bilisht-Korçë-Bilisht që të zbatojnë të gjitha të drejtat dhe përfitimet që u takojna personave ve me aftësi të kufizuara, ashtu siç është parashikuar edhe në ligj.*

*Subjekti ynë ka përpiluar edhe një rregullore të brendshme, të firmosur nga çdo shofer i Shoqërisë, që në çdo rast të jenë të informuar për lehtësirat dhe përfitimet që kanë PAK.*

*Ju sigurojmë se raste të tilla nuk do të ketë absolutisht në të ardhmen...”*

Shoqëria depozitoi prova/foto të masave të marra, lidhur me afishimin e parashikimeve ligjore për përfitimin e lehtësirave në transportin urban për të gjitha kategoritë PAK të parashikuara në ligj, përfshirë edhe kategorinë e personave të verbër dhe shoqëruesve të tyre, në të 9 (nëntë) automjetet e disponuara prej saj për ofrimin e shërbimit urban në linjën Bilisht-Korçë-Bilisht.

Lidhur me informacionin e përcjellë nga ana e Shoqërisë “Xhea Trans”, për masat e ndërmarra prej saj për respektimin e të drejtës së PAK për përfitimin e lehtësirave në udhëtimin në transportin urban, ankuesi deklaroi gjatë seancës se: *...e konsideroj masë pozitive dhe të arritur qëllimin për të cilin është paraqitur ankesa, nëse vërtet janë ndërmarrë këto masa nga ana e Shoqërisë”*.

Lidhur me këtë moment, z. F kërkoi që t'i lihej afat deri më datë 23.12.2024, për të verifikuar deklarinimin e Shoqërisë. U dakordësua që, deri më datë 23.12.2024, KMD-ja, të informohej nga pala ankuese lidhur me verifikimet e bëra në linjën në fjalë.

8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1180/6 prot., datë 26.11.2024, Komisioneri, njohu palën ankuese me aktet e dërguara nga Shoqëria “Xhea Trans” shpk:
  - Rregullore e nënshkruar me përfaqësuesit, ortakët dhe shoferët e automjeteve të licencuara për ofrimin e shërbimit urban me Shoqërinë “Xhea Trans” shpk;
  - si dhe fotot e automjeteve të saj, ku konstatohet se është afishuar legjislacioni për përfitimin e lehtësirave në transportin urban për PAK, dërguar nga Shoqëria, në përgjigje të masave të ndërmarra prej saj, lidhur me rastin në fjalë, me qëllim mospërsëritjen e tij në të ardhmen, për linjën e transportit Bilisht-Korçë.
9. Nëpërmjet e-mailit datë 23.12.2024, i është kërkuar z. F, të shprehë qëndrimin e tij lidhur me provat e dërguara nga subjekti “Xhea Trans” shpk, si dhe të njoftojë Komisionerin, lidhur rezultatet e verifikimeve të kryera prej tij, sipas kërkesës së shprehur gjatë seancës dëgjimore të datës 21.11.2024, pranë KMD-së.
10. Pala ankuese, z. F<sup>3</sup> nuk ka dërguar pranë KMD-së asnjë parashtrim, argument, provë apo fakt lidhur me verifikimin e sa më sipër. Në këto kushte, Komisioneri merr të mirëqenë faktin se, meqenëse nga ankuesi nuk u depozituan kundërshtime apo fakte, lidhur me vërtetësinë e provave të depozituara nga subjekti “Xhea Trans” shpk, në vendimmarrjen e tij, do të referohet tek deklarimi i bërë nga z. F gjatë seancës dëgjimore.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, si dhe nisur nga fakti se vetë ankuesi, (bazuar në deklarinimet e bëra gjatë seancës dëgjimore të datës 21.11.2024), është dakordësuar se tërhiqet nga ankesa, me marrjen e masave sipërcituar nga ana e Shoqërisë<sup>4</sup>, pasi konsideron arritjen e efektivitetit të ankuesës së paraqitur pranë KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është*

<sup>3</sup> Referuar këmbimit të e-maileve të datës 26.12.2024

<sup>4</sup> Në kushtet kur prej tij nuk u vërtetua e kundërta, përmes inspektimit që do të kryente në autobusët e kësaj Shoqërie, sikurse u deklarua në seancë.

*paraqitur ankesa*”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. ankesën me nr. 169 Regj., datë 23.08.2024, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit S. F, nga linja e transportit të udhëtarëve Bilisht-Korçë dhe anasjelltas, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore<sup>5</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 169 Regj., datë 23.08.2024, të z. S. F, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është

---

<sup>5</sup> Për analogji citojmë vendimin nr. 178, datë 04.06.2024, të KMD-së.

tërhequr nga ankesa<sup>6</sup>, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Rekomandohet Shoqëria e Transportit të udhëtarëve “Xhea Trans” shpk, me qëllim parandalimin në të ardhmen, të situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masa për trajnimin e detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave ligjore të parashikuara për këtë kategori.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>6</sup> Referuar deklarimeve të ankuesit gjatë seancës dëgjimore të datës 21.11.2024, pranë KMD-së, sipas procesverbalit të mbajtur gjatë saj.